



**VENDIM**  
**Nr. 28, datë 20.5.2016**

**PËR MIRATIMIN E FINANCIMIT PËR  
VITIN 2016, PËR DISA PROJEKTE NË  
VAZHDIM TË GRANTIT  
“INFRASTRUKTURA VENDORE DHE  
RAJONALE”, PROGRAMI I ZHVILLIMIT  
VENDOR DHE RAJONAL, SHTYLLA I**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 15, të aneksit 3, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

**VENDOSI:**

1. Miratimin e vazhimit të financimit për vitin 2016, për disa projekte në vazhdim me cikël financimi 2014–2015, për grantin “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, programi i zhvillimit vendor dhe rajonal, shtylla I, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Miratimin e vazhimit të financimit për vitin 2016, për disa projekte në vazhdim me cikël financimi 2015–2016, për grantin “Infrastruktura

vendore dhe rajonale”, programi i zhvillimit vendor dhe rajonal, shtylla I, sipas tabelës 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban dhe ministri i Financave, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYETARI**  
**Niko Peleshi**

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar,
Ministri i Financave	anëtar,
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar,
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar,
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar,
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar,
Ministri i Shëndetësisë	anëtar,
Ministri i Kulturës	anëtar,
Ministri i Mjedisit	anëtar,
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar,
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar,
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar,
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar,
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar,
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar,
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar,
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.

Tabela 1. Lista e disa projekteve me cikël financimi 2014–2015, granti infrastruktura vendore dhe rajonale, programi i zhvillimit vendor dhe rajonal, shtylla I, vazhdimi i financimit për vitin 2016

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vendimi(et) i/e KZHR-së	Vlera e projektit (në lekë)	Vlera e kontratës (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2014 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (në lekë)	Vlera e mbetur e financimit për vitin 2016 (në lekë) /veprim korrektes (*)
<b>QARKU FIER</b>									
1	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksion i rrugës Çermë Sektor, Tre urat-Staravec-Gërmenj i Madh, Tre Urat-Autostradë Rrogozhin-Lushnje L=16Km (Unaza Divjakë)	Nr. 16, datë 10.10.2014	425,016,000	245,507,020	127,504,000	116,354,216	-	1,648,804
<b>QARKU TIRANË</b>									
2	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksioni i rrugës Porcelan - Kinostudio - Surrel	Nr. 14, datë 23.9.2014	417,207,528	264,041,996	54,106,626	162,770,374	-	47,164,996
3	Komuna Farkë	Sistemim dhe asfaltim i rrugëve përreth liqenit Farkë, shëtitore, ndërtim KUB, KUZ, aksi 1, aksi 2	Nr. 2, datë 9.4.2014	39,576,000	36,023,552	35,071,517	1,852,035	-	-900,000*
<b>QARKU VLORE</b>									
4	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Lidhja e rrugës TransBallkanike me superstradën Fier-Vlorë	Nr. 16, datë 10.10.2014	641,123,002	349,178,357	192,336,900	154,012,361	-	2,829,096
<b>QARKU KORÇË</b>									
5	Bashkia Korçë	Sheshi dhe rrugicat tek kulla panorama, sheshi tek teatri	Nr. 2, datë 9.4.2014	241,914,630	241,191,892	229,000,000	12,191,892	-722,738	-
6	Bashkia Korçë	Rikonstruksion i parkut Rinia	Nr. 2, datë 9.4.2014	304,502,223	303,596,161	258,000,000	45,596,161	-906,062	-
<b>TOTALI</b>				<b>2,069,339,383</b>	<b>1,439,538,978</b>	<b>896,019,043</b>	<b>492,777,039</b>	<b>-1,628,800</b>	<b>51,642,896</b>



## Shënim

1. “Vlera e projektit” përfaqëson vlerën e projektit të miratuar me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve. Kjo vlerë përbëhet nga vlera e investimit dhe vlera e supervizimit dhe kolaudimit.

2. “Vlera e kontratës” përfaqëson vlerën e kontraktuar nga autoriteti kontraktues për zbatimin e punimeve të projektit, të miratuar nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve dhe shumatorja e saj me vlerën e supervizimit dhe kolaudimit “korrekton” vlerën e projektit. Vlera e kontratës përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Zhvillimit Urban).

3. “Vlera e financimit për vitin 2014” tregon vlerën e alokuar për vitin 2014, sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

4. “Vlera e financimit për vitin 2015” tregon vlerën e alokuar për vitin 2015, për të përmbyllur financimin e vlerës së kontratës, sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

5. “Vlera e financimit për vitin 2016”, tregon vlerën e alokuar për vitin 2016, sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, për projektin me nr. 5 dhe 6, të tabelës nr. 1 të këtij vendimi. Për këto projekte shfuqizohet vlera e financimit, me minus, për vitin 2016, dhënë sipas vendimit nr. 9, datë 10.3.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve. Vlera e mbetur e financimit për vitin 2016, për këto projekte është në vlerën 0 lekë. Gabimi në përlogaritjen e financimit për vitin 2016, në vendimin e sipërpërmendur është bërë nga sekretariati teknik (Ministria e Zhvillimit Urban), i cili me shkresë nr. 3152 prot., datë 16.5.2016, propozon korrektimin e kësaj vlere financimi.

6. “Vlera e mbetur e financimit për vitin 2016”, tregon diferencën midis vlerës së projektit me vlerën e kontratës dhe atë të financimit për vitet 2014, 2015 dhe 2016, dhënë deri tani, që përbën vlerën e supervizimit dhe kolaudimit, e miratuar për projektet me autoritet kontraktues Fondin Shqiptar të Zhvillimit, sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve. Propozimi për financimin e kësaj vlere ka ardhur nga sekretariati teknik (Ministria e Zhvillimit Urban), me shkresë nr. 3152 prot., datë 16.5.2016.

7. “Veprimi korrektues për vitin 2016” është vlera me minus që zvogëlon vlerën e financimit për vitin 2016, kur financimi i vlerës së projektit dhe/ose i vitit 2016, mbas nxjerrjes së vlerës së kontratës (nënshkrimit), duhet zbritur respektivisht. Financimi i papërdorur është thithur në zarinë e grantit përkatës. Propozimi ka ardhur nga sekretariati teknik (Ministria e Zhvillimit Urban), me shkresë nr. 3152 prot., datë 16.5.2016.

8. Për projektin nr. 3 të kësaj liste, me emërtim “Sistemim dhe asfaltim i rrugëve përreth liqenit Farkë, shëtitore, ndërtim KUB, KUZ, aksi 1, aksi 2”, referuar ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrative territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, Komuna Farkë konsiderohet ish-autoriteti kontraktues dhe Bashkia Tiranë është autoriteti kontraktues.

Tabela 2. Lista e disa projekteve me cikël financimi 2015–2016, granti infrastruktura vendore dhe rajonale, programi i zhvillimit vendor dhe rajonal, shtylla I, vazhdimi i financimit për vitin 2016

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emri i projektit	Vendimi(et) i/e KZHR-së	Vlera e projektit (në lekë)	Vlera e kontratës (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (në lekë)	Vlera e mbetur e financimit për vitin 2016 (në lekë)
<b>QARKU DIBËR</b>								
1	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Ndërtimi i Urës së Lushës mbi lumin Drin i Zi, Komuna Arras	Nr. 17, datë 16.3.2015	75,330,337	72,955,154	52,731,236	18,918,556	1,305,362
<b>QARKU ELBASAN</b>								
2	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksion i rrugës Librazhd-Orenjë	Nr. 22, datë 8.5.2015	30,450,000	28,256,975	21,315,000	6,654,585	287,390
<b>QARKU FIER</b>								
3	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksion i rrugës “Kithesa e Bishanit - Bocove - Varrezat e fshatit Bashkim”	Nr. 22, datë 8.5.2015	88,531,238	59,143,978	61,971,867	-3,354,747	526,858
4	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksion i rrugës Kamcisht-Ngurrëz e Vogël, Komuna Krutje, Fier	Nr. 27, datë 29.5.2015	42,499,964	27,774,050	29,749,975	-2,247,725	271,800
5	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksion i Rrugës Adë (Karburanti)-Frakull e Vogël, Komuna Frakull	Nr. 10, datë 25.2.2015	82,273,041	44,797,524	57,591,129	-13,151,333	357,728
6	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksion i rrugës Levan-Shtyllas, Komuna Levan	Nr. 10, datë 25.2.2015	126,730,510	84,873,826	69,844,804	14,468,684	560,338
7	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Sistemim asfaltim i rrugës Tozhgez-Zhelizhan-Mazhaj, Komuna Allkaj	Nr. 10, datë 25.2.2015	98,928,509	58,538,542	66,185,397	-8,082,609	435,754
<b>QARKU GJIRKASTËR</b>								
8	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Ndërtim i rrugëve në qendër të fshatit Jorgucat	Nr. 17, datë 16.3.2015	58,037,138	39,134,035	40,178,205	-1,418,517	374,347
9	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksion dhe asfaltimi i rrugës së fshatit Peshtan, Komuna Qendër Tepelenë	Nr. 10, datë 25.2.2015	25,254,944	16,022,058	17,678,461	-1,818,121	161,718
10	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rruga e fshatit Goranxi, Komuna Dropull i Sipërm	Nr. 10, datë 25.2.2015	57,288,131	38,407,308	40,101,692	-2,013,092	318,708
11	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rehabilitim dhe sistemim i sheshit në qendër të fshatit “Asim Zenel”, qendër e Komunës Antigone	Nr. 22, datë 8.5.2015	28,415,479	18,784,498	19,890,835	-1,332,407	226,070



QARKU KORÇË								
12	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksion i sheshi qendror të fshatit Pustec, Komuna Pustec	Nr. 17, datë 16.3.2015	34,981,682	24,778,151	24,441,529	271,410	65,212
13	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Sistemimi anësor i Përroit të Madh Qendër Fshati Voskop	Nr. 17, datë 16.3.2015	46,550,605	30,856,168	31,762,149	-1,425,671	519,690
QARKU LEZHË								
14	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksioni i rrugës Grykë Manati - Kolsh L=1947 ml dhe ndërtim i rrugës së Varrezave L=530 ml, komuna Kolsh, Lezhë	Nr. 27, datë 29.5.2015	69,502,124	38,400,312	48,651,487	-12,368,107	2,116,932
15	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Sistemim, asfaltim i rrugës Sanxhak, Superstradë	Nr. 22, datë 8.5.2015	101,142,279	94,578,667	70,799,595	23,077,887	701,185
QARKU SHKODËR								
16	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rivitalizimi i ndërtësive dhe shëtitorja e lumit në Tamarë	Nr. 10, datë 25.2.2015+ Nr. 43, datë 27.11.2015	63,015,374	56,361,740	44,110,762	12,153,178	97,800
QARKU TIRANË								
17	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Ndërtim i shëtitores, KUZ, te liqeni i Farkës, Komuna Farkë	Nr. 10, datë 25.2.2015	90,765,048	70,720,365	63,535,534	6,605,475	579,356
18	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rehabilitimi i kryqëzimit të Shkozës, Bashkia Tiranë	Nr. 10, datë 25.2.2015	27,324,616	18,574,128	19,127,230	-767,146	214,044
QARKU VLORË								
19	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Ndërtimi i shëtitores së Himarës	Nr. 32, date 15.7.2015	264,782,826	234,314,128	105,913,130	126,969,448	1,431,550
20	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Ndërhyrje për mbrojtjen detare të plazhit, të formuar nga projekti i Lungomares	Nr. 32, datë 15.7.2015	35,985,600	35,443,072	14,394,240	20,928,952	119,880
<b>TOTALI</b>				<b>1,447,789,445</b>	<b>1,092,714,679</b>	<b>899,974,257</b>	<b>182,068,700</b>	<b>10,671,722</b>

## Shënim

1. “Vlera e projektit” përfaqëson vlerën e projektit të miratuar me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve. Kjo vlerë përbëhet nga vlera e investimit dhe vlera e supervizimit dhe e kolaudimit.

2. “Vlera e kontratës” përfaqëson vlerën e kontraktuar nga autoriteti kontraktues për zbatimin e punimeve të projektit, të miratuar nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve dhe shumatorja e saj me vlerën e supervizimit dhe kolaudimit “korrekton” vlerën e projektit. Vlera e kontratës përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Zhvillimit Urban).

3. “Vlera e financimit për vitin 2015” tregon vlerën e alokuar për vitin 2015, sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

4. “Vlera e financimit për vitin 2016” tregon vlerën e alokuar për vitin 2016, për të përmbyllur financimin e vlerës së kontratës, sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

5. “Vlera e mbetur e financimit për vitin 2016”, tregon diferencën midis vlerës së projektit me vlerën e kontratës dhe atë të financimit për vitet 2014, 2015 dhe 2016, dhënë deri tani, që përbën vlerën e supervizimit dhe kolaudimit, e miratuar për projektet me autoritet kontraktues Fondin Shqiptar të Zhvillimit, sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve. Propozimi për financimin e kësaj vlere përcillet nga Sekretariati teknik (Ministria e Zhvillimit Urban), me shkresë nr. 3152 prot., datë 16.5.2016.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2016

Adresa:  
Bulevardi “Gjergj Fishta”  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”  
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 84 lekë